

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“AUDITIMI I JASHTËM I PROJEKTEVE DHE GRANTEVE ME FINANCIM TË HUAJ
PËR VITIN 2024, 2025, 2026”, NDARË NË 2 LOTE:**

**LOTI 1: “AUDITIMI I PROJEKTEVE DHE GRANTEVE TË FINANCUARA NGA
BANKA BOTËRORE”**

**LOTI 2: “AUDITIMI I PROJEKTEVE DHE GRANTEVE TË FINANCUARA NGA
DONATORË TË TJERË”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) **79212000-3**

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,815,000 (tetë milion e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë PA
TVSH, ndarë në 2 (dy) lote si më poshtë:

Loti 1: “Auditimi i Projekteve dhe Granteve të financuara nga Banka Botërore”, me fond limit në
vlerën 4,300,000 (katër milion e treqind mijë) lekë pa tvsh.

Loti 2: “Auditimi i Projekteve dhe Granteve të financuara nga Donatorë të tjerë”, me fond limit në
vlerën 4,515,000 (katër milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar
procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për
kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**LOTI 1: “AUDITIMI I PROJEKTEVE DHE GRANTEVE TË FINANCUARA NGA
BANKA BOTËRORE”**

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë si Auditues Ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë licensën dhe dokumentin përkatës të regjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitetin profesional që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të jetë plotësisht i pranuar nga Banka Botërore për të audituar pasqyra financiare të përgatitura në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit (IFRS).

Kjo pikë konsiderohet e përmbushur nëse ofertuesi është pjesë e listës së audituesve “plotësisht të pranuar” të Bankës Botërore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin përkatës, ku të pasqyrohet se është pjesë ***e listës së audituesve “plotësisht të pranuar” të Bankës Botërore.***

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe kërkesës së financuesit të projekteve për të cilat do të kryhet prokurimi, që në rastin konkret është Banka Botërore. Kjo kërkesë lidhet drejtëpërdrejtë me natyrën e projekteve objekti prokurimi, pra ato të financuara nga Banka Botërore, dhe me standartet specifike që ky institucion kërkon për auditimet e tij.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar, stafin teknik si më poshtë:

- a) 2 (dy) punonjës ose ortakë të shoqërisë, me titull profesional “Auditues Ligjor”

b) 4 (katër) punonjës të angazhuar

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

➤ Për Punonjësit në pikën a) ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme),
- certifikatë e Audituesit Ligjor;
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 3 (tre) vite.

➤ Për punonjësit në pikën b, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme),
- diplomë e arsimit të lartë (të ciklit të dytë) në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomik apo të barasvlershme me to;
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit.

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës hartuar nga AK, për llogari të së cilit po zhvillohet procedura e prokurimit.

Ky kriter vendoset për të garantuar cilësinë, integritetin dhe përputhshmërinë profesionale të shërbimit të auditimit, duke u bazuar në kërkesat e standarteve kombëtare/ndërkombëtare të auditimit dhe natyrën e vetë procesi të auditimit.

Duke qenë standartet kombëtare/ndërkombëtare të auditimit kërkojnë ndarje rolesh, analizë financiare, vlerësim të risqeve, planifikim, verifikim, mbikëqyrje të proceseve të punës, janë kërkuar minimalisht 2 punonjës/ortakë me titull profesional “Auditues ligjor”, me qëllim garantimin e integritetit dhe cilësinë e auditimit. Dy auditues ligjorë sigurojnë kontrollin dypalësh (parimi i katër syve) mbi dokumentacionin rezultat i procesit të auditimit, shmangien e e riskut të gabimeve materiale.

Punonjësit ndihmës janë pjesë e domosdoshme e ekipit për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, kryerjen e testeve të përputhshmërisë, përgatitjen e dokumentacionit që do të auditohet, verifikimet fizike, etj. Nisur nga afati i përcaktuar për kryerjen e auditimit (2 muaj nga nënshkrimi i minikontratës/ave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër) dhe rëndësinë që paraqet elementi kohë në realizimin e këtij shërbimi, numri 4 i punonjësve ndihmës konsiderohet si një numër minimal për të mbuluar të gjitha proceset e punës që janë të nevojshme për këtë shërbim.

Nisur nga kompleksiteti teknik i procesit të auditimit, i cili kërkon ushtrim të gjykimit profesional, vlerësim të riskut, analizë të sistemeve të kontrollit, etj., si dhe duke mbajtur në konsideratë që Audituesi ligjor mban përgjegjësi të lartë për opinionion dhe gjykimin e tij profesional në shërbimin e auditimit vlerësohet se eksperiencia minimale prej 3 vite e audituesve ligjorë është niveli minimal që garanton pjekuri profesionale dhe aftësi për të marrë vendime të pavarura. Eksperiencia e kërkuar për audituesit ligjor është vendosur gjithashtu duke iu referuar nenit 15 të Ligjit Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kohëzgjatja e praktikës profesionale është në total 3 (tre) vjet, si kusht për të marrë titullin Auditues ligjor.

Eksperiencia minimale të paktën 1 vit, për punonjësit ndihmës, vlerësohet si minimumi i arsyeshëm për të garantuar që punonjësit ndihmës mund të punojnë në mënyrë të pavarur brenda fushës së tyre të përgjegjësisë. Pavarësisht se punonjësit ndihmës nuk hartojnë opinion, kontributi i tyre është thelbësor në të gjitha proceset e punës së shërbimit objekt prokurimi, si analizë financiare, mbledhje të dhënash, verifikimet dokumentare, përgatitja e materiale të dosjes, etj, mbi të cilat audituesit ligjorë do të hartojnë raportin e auditimit. Një periudhë më e shkurtër nuk garanton që këta punonjës kuptojnë ciklin e plotë të auditimit, njohin dokumentet standarte, dinë të punojnë me programet e auditimit dhe mjetet analitike. Eksperiencia e kërkuar për punonjësit dhe arsimi i kërkuar është vendosur gjithashtu duke iu referuar nenit 15 (pra duke vendosur si kriter më pak se gjysmën e praktikës profesionale e cila zgjat 3 vite) dhe nenit 16 të Ligjit Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Punësimi i punonjësve të kërkuar më sipër pranë OE ofertues, për periudhën e fundit është një tregues që garanton aftësinë reale të ofertuesit për të kryer shërbimin, kapacitetin real të tij me punonjës aktivë, të cilët janë të përgatitur dhe të njohur me standartet dhe procedurat e punës që zbaton ofertuesi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se do të realizojë shërbimin objekt prokurimi në përputhje me standartet e parimet profesionale që kërkojnë për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Shërbimi i auditimit është një shërbim i rregulluar nga aktet ligjore e nënligjore të zbatueshme, shumë i ndjeshëm pasi ka ndikim të drejtëpërdrejtë në besueshmërinë financiare të projekteve dhe fondeve të donatorëve të huaj. Për këtë arsye, realizimi i auditimi nuk është vetëm proces teknik, por kërkon pavarësi etike, integritet profesional, objektivitet, konfidencialitet, kompetencë profesionale, shmangie të konfliktit të interesit, respektim të standarteve kombëtare/ndërkombëtare të auditimit. Sa më sipër, vlerësohet e nevojshme që ofertusi të deklarojë pajtueshmërinë e realizimit të shërbimit objekt prokurimi me standartet dhe garancitë etike e morale, si themel i përgjegjësisë profesionale dhe ligjore.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur/hartuar/përcjellë nga Autoriteti Kontraktor “Ministria e Financave”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/termat e referencës janë pjesë e pandashme e DST.

LOTI 2: “AUDITIMI I PROJEKTEVE DHE GRANTEVE TË FINANCUARA NGA DONATORË TË TJERË”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesive ligjorë si Auditues Ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë licensën dhe dokumentin përkatës të regjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitetin profesional që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar,

duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar, stafin teknik si më poshtë:

- a) 2 (dy) punonjës ose ortakë të shoqërisë, me titull profesional “Auditues Ligjor”
- b) 4 (katër) punonjës të angazhuar

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

➤ Për Punonjësit në pikën a) ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme),
- certifikatë e Audituesit Ligjor;
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 3 (tre) vite.

➤ Për punonjësit në pikën b, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme),
- diplomë e arsimit të lartë (të ciklit të dytë) në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomik apo të barasvlershme me to;
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit.

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës hartuar nga AK, për llogari të së cilit po zhvillohet procedura e prokurimit.

Ky kriter vendoset për të garantuar cilësinë, integritetin dhe përputhshmërinë profesionale të shërbimit të auditimit, duke u bazuar në kërkesat e standarteve ndërkombëtare të auditimit dhe natyrën e vetë procesi të auditimit.

Duke qenë standartet kombëtare/ndërkombëtare të auditimit kërkojnë ndarje rolesh, analizë financiare, vlerësim të risqeve, planifikim, verifikim, mbikëqyrje të proceseve të punës, janë kërkuar minimalisht 2 punonjës/ortakë me titull profesional “Auditues ligjor”, me qëllim garantimin e integritetit dhe cilësinë e auditimit. Dy auditues ligjorë sigurojnë kontrollin dypalësh

(parimi i katër syve) mbi dokumentacionin rezultat i procesit të auditimit, shmagjen e e riskut të gabimeve materiale.

Punonjësit ndihmës janë pjesë e domosdoshme e ekipit për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, kryerjen e testeve të përputhshmërisë, përgatitjen e dokumentacionit që do të auditohet, verifikimet fizike, etj. Nisur nga afati i përcaktuar për kryerjen e auditimit (2 muaj nga nënshkrimi i minikontratës/ave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër) dhe rëndësinë që paraqet elementi kohë në realizimin e këtij shërbimi, numri 4 i punonjësve ndihmës konsiderohet si një numër minimal për të mbuluar të gjitha proceset e punës që janë të nevojshme për këtë shërbim.

Nisur nga kompleksiteti teknik i procesit të auditimit, i cili kërkon ushtrim të gjykit profesional, vlerësim të riskut, analizë të sistemeve të kontrollit, etj., si dhe duke mbajtur në konsideratë që Audituesi ligjor mban përgjegjësi të lartë për opinionion dhe gjykimin e tij profesional në shërbimin e auditimit vlerësohet se eksperiencia minimale prej 3 vite e audituesve ligjorë është niveli minimal që garanton pjekuri profesionale dhe aftësi për të marrë vendime të pavarura. Eksperiencia e kërkuar për audituesit ligjor është vendosur gjithashtu duke iu referuar nenit 15 të Ligjit Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku përcaktohet se kohëzgjatja e praktikës profesionale është në total 3 (tre) vjet, si kusht për të marrë titullin Auditues ligjor.

Eksperiencia minimale të paktën 1 vit, për punonjësit ndihmës, vlerësohet si minimumi i arsyeshëm për të garantuar që punonjësit ndihmës mund të punojnë në mënyrë të pavarur brenda fushës së tyre të përgjegjësisë. Pavarësisht se punonjësit ndihmës nuk hartojnë opinion, kontributi i tyre është thelbësor në të gjitha proceset e punës së shërbimit objekt prokurimi, si analizë financiare, mbledhje të dhënash, verifikimet dokumentare, përgatitja e materiale të dosjes, etj, mbi të cilat audituesit ligjorë do të hartojnë raportin e auditimit. Një periudhë më e shkurtër nuk garanton që këta punonjës kuptojnë ciklin e plotë të auditimit, njohin dokumentet standarte, dinë të punojnë me programet e auditimit dhe mjetet analitike. Eksperiencia e kërkuar për punonjësit dhe arsimi i kërkuar është vendosur gjithashtu duke iu referuar nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Punësimi i punonjësve të kërkuar më sipër pranë OE ofertues, për periudhën e fundit është një tregues që garanton aftësinë reale të ofertuesit për të kryer shërbimin, kapacitetin real të tij me punonjës aktivë, të cilët janë të përgatitur dhe të njohur me standartet dhe procedurat e punës që zbaton ofertuesi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se do të realizojë shërbimin objekt prokurimi në përputhje me standartet e parimet profesionale që kërkojnë për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Shërbimi i auditimit është një shërbim i rregulluar nga aktet ligjore e nënligjore të zbatueshme, shumë i ndjeshëm pasi ka ndikim të drejtëpërdrejtë në besueshmërinë financiare të projekteve dhe fondeve të donatorëve të huaj. Për këtë arsye, realizimi i auditimi nuk është vetëm proces teknik, por kërkon pavarësi etike, integritet profesional, objektivitet, konfidencialitet, kompetencë profesionale, shmangie të konfliktit të interesit, respektim të standarteve kombëtare/ndërkombëtare të auditimit. Sa më sipër, vlerësohet e nevojshme që oferteusi të deklarojë pajtueshmërinë e

realizimit të shërbimit objekt prokurimi me standartet dhe garancitë etike e morale, si themel i përgjegjësisë profesionale dhe ligjore.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur/hartuar/përcjellë nga Autoriteti Kontraktor “Ministria e Financave”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/termat e referencës janë pjesë e pandashme e DST.